

Ligj 57/2023 Datë 21.7.2023

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 2, DATË 7.6.2023 “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 29/2023
‘PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT’”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 7.6.2023, i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa në ligjin nr. 29/2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”.

Miratuar në datën 21.7.2023.

Shpallur me dekretin nr.170, datë 28.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Botuar ne F.Zyrtare 116/2023

Dale nga shtypi me 03.08.2023

AKT NORMATIV Nr. 2, datë 7.6.2023
PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 29/2023,
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas pikës 3, të nenit 69, “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, shtohen pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“4. Përjashtimisht parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, nuk paguajnë këstet që parapaguhën në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të vitit 2023.

5. Deri në datën e fillimit të efekteve të këtij ligji, sipas përcaktimit të nenit 72 të tij, zbatohen parashikimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

Botuar ne F.Zyrtare 92/2023

Dale nga shtypi me 23.06.2023